



Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji, bazuar në:

- Dispozitat e Neneve 14 dhe 25 të Ligjit Nr. 03/L-185 për Rregullatorin e Energjisë,
- Dispozitat e Nenit 49.2 të Rregullit për Licencimin e Aktiviteteve të Energjisë në Kosovë, dhe Nenit 4 të Licencës së Operatorit të Sistemit të Transmisionit,
- Kërkesën e KOSTT SH.A për amendamentimin e Kodit të Standardeve Elektrike dhe Kodit të Pajisjeve Elektrike të datës 05 tetor 2011,

në seancën e mbajtur më 28 tetor 2011 ka nxjerrë këtë:

VENDIM

I lejohe KOSTT SH.A. amendamenti i dispozitave të Kodit të Standardeve Elektrike dhe Kodit të Pajisjeve Elektrike si në Shtojcë të këtij vendimi.

ARSYETIM

Zyra e Rregullatorit për Energji me datë 05 tetor 2011 ka pranuar Kërkesën e KOSTT SH.A për amendamentimin e Kodit të Standardeve Elektrike dhe Kodit të Pajisjeve Elektrike. Pas vlerësimit të kërkesës dhe duke pasur parasysh gjendjen aktuale dhe zhvillimet në Sistemin e Transmisionit, ZRrE ka parë të arsyeshme që të lejojë amendamentimin e dispozitave të Kodit të Standardeve Elektrike dhe Kodit të Pajisjeve Elektrike të vendosura si në Shtojcë.

Të gjitha dispozitat tjera të Kodit të Standardeve Elektrike dhe Kodit të Pajisjeve Elektrike do të mbesin në fuqi.

Vendimi nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe angleze. Në rast të mospërputhjes midis versioneve, do të mbizotërojë versioni në gjuhën shqipe.

Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi i Zyrës së Rregullatorit dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRrE-së.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi, pala e pakënaqur mund t'i drejtohet Gjykatës Kompetente, brenda katërmëdhjetë (14) ditëve, nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të Vendimit në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhë e fundit.

Shtojcë: Amendamentimet e lejuara.

Bordi i ZRrE-së

Dr. Ali Hamiti, Kryesues

Blerim Koci, Anëtar

Përparim Kabashi, Anëtar

Enver Halimi, Anëtar